



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 41
Prishtinë, më 7 qershor, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-204-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Avdullah Hoti, Emilija Rexhepi, Albert Kinolli, Ali Lajçi, Andin Hoti, Etem Arifi dhe Valon Ramadani.

Munguan: Verica Ceraniq dhe Faton Topalli.

Stafi mbështetës: Antigona Ibraj, Ajet Avdullahu dhe Aurel Haxhiu.

Pjesëmarrësit tjerë: Dejana Zhiriq Kapllan Halimi, Ekrem Gjokaj, Zoran Spasiq, Vlora Spanca, Agron Hoxha, Violeta Smajlaj, Saranda Hysaj Baraliu, Nora Kelmendi, Arta Dehari, Marigona Berisha, Kushtrim Xhemali, Alban Avdiu, Jover Lofia, Vatra Qehaja, Boban Saviq dhe Milena Aksiq.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 29.05.2019;
3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Performancës, Procesi i Menaxhimit të Grandeve dhe Subvencioneve në sektorin e bujqësisë;
4. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua nga deputetët e pranishëm.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.05.2019

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 29.05.2019, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Performancës, Procesi i Menaxhimit të Grandeve dhe Subvencioneve në sektorin e bujqësisë

Kryetari përshëndeti të pranishmit dhe tregoi se e ftuar në komision është ministrja e MBPZHR, e cila do t' i arsyetojë të gjeturat e raportit të auditimit.

Dijana Zhiviq: Të nderuar deputetë, të nderuar kolegë, unë ju falënderoj për ftesën, po ashtu e kemi marrë edhe këtë raport për të cilën periudhë unë nuk kam qenë ministre, megjithatë këtë unë ju garantoj që do të mundohemi që të gjitha rekomandimet t' i shqyrtojmë dhe zbatojmë me kujdes, po ashtu ju garantoj që gjatë mandatit tim do të punoj me përgjegjësi të plotë bazuar në ligjet dhe rregullat të cilat na obligojnë në punën tonë. Për njoftimin e juaj ne jemi në procesin e analizimit të të gjitha raporteve tona, po ashtu edhe të programit për zhvillimin e bujqësi 2014-2020, i cili është duke u punuar nga 6 ekspertë të Unionit Evropian dhe tre ekspertë vendorë, ku do të shqyrtohet çdo raport në lidhje me këtë program dhe të vlerësoj nëse paraja publike po shkon ku duhet dhe te bizneset e duhura dhe me pas do t' i marrim vendimet adekuate. Sa i përket këtij raporti ne kemi pasur disa diskutime sepse kemi vlerësuar se auditorët e ZKA-se nuk kanë qenë ekspertë të bujqësisë dhe prandaj jo çdo të gjetur kanë arritur ta argumentojnë, po ashtu auditorët nuk kanë arritur t' i deshifrojnë standardet ndërkombëtare të kësaj fushë me të cilat ne i hartojmë programet tona. Sa i përket bashkëpunimit me Komunitet në çdo rast i kemi ftuar edhe komunitet përkatësisht drejtorit për bujqësi, po ashtu nga mandati im kemi hapur qendra të informimit për zhvillimin e bujqësisë në mënyrë që qasja e qytetarëve të jetë sa më e lehtë. Dhe në fund të nderuar deputetë puna ime gjatë këtij mandati do të jetë tërësisht transparente për të gjithë.

Vlora Spanca, tha se ZKA në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit ka kryer auditimin e performancës për të vlerësuar mënyrën e menaxhimit të procesit të dhënies së granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë. Znj. Spanca tha se objektivi i këtij auditimi ishte që të vlerësohet nëse institucionet publike përmes granteve dhe subvencioneve kanë arritur synimet e përcaktuar në zhvillimin e bujqësisë. Subjekt i këtij auditimit tha se kanë qenë Zyra e Kryeministrit; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Komuna e Prishtinës, Komuna e Ferizajt dhe Komuna e Prizrenit, si komuna me buxhet më të lartë në kategorinë e grandeve dhe subvencioneve. Auditimi ka mbuluar periudhën e viteve 2016, 2017 dhe 2018.

Ajo shtoi se auditimi ka nxjerrë në pah që pavarësisht rritjes së investimeve publike në sektorin e bujqësisë Qeveria e Kosovës nuk i ka arritur synimet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare ashtu edhe në programet në nivel qendror dhe komunal. Procesi i mbështetjes për këtë sektor është përcjellë me mangësi. Programi për Zhvillim Rural 2014-2020 është zbatuar pa u dërguar për miratim, mos kalimi i programit në nivelet e parapara në ligj ka pasur ndikim negativ në mos themelimin e strukturave sipas parimeve dhe rregullave të IPARD-it. Për dallim nga vendet e rajonit Kosova nuk ka përfunduar fonde nga BE-ja për masat e parapara në sektorin e bujqësisë. Rezultatet e synuara mungojnë dhe nuk ka të dhëna që tregojnë se këto punë dhe mënyra e mbështetjes nga ministria ka ndikim pozitiv në zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Programet vjetore po ashtu nuk menaxhohen mirë, që nga procesi i aprovimit deri te nënshkrimi i kontratës me fermerë, agrobiznese zgjatë deri në 8 muaj, ky proces ndikon te fermerët dhe agrobizneset pasi që gjithmonë ka vonesa në pagesa dhe mund t'ju shkaktoj probleme në mënyrën e zhvillimit të bizneseve të tyre.

Për më shumë janë miratuar dhe programe të veçanta pa ndonjë analizë paraprake që arrijnë vlerën monetare mbi 6 milionë euro. Këto programe përmbajnë pothuajse masa të ngjashme vjetore, madje janë dhënë fonde dhe janë angazhuar kompani për trajnime pa vlerësuar dhe analizuar gjendjen reale dhe përkundra faktit se një kontraktim i tillë ekzistonte për tërë vendin. Po ashtu monitorimi i këtyre

kompanive pothuajse mungon fare nga ministria dhe ministria është e kufizuar për t'i ndjekur efektet e trajnimit të fermerët.

ZKA-ja po ashtu ka gjetur mos harmonizim të kriterëve mes udhëzimit administrativ dhe programeve të shpallura dhe ka pasur paqartësi nëse fermerët u janë përmbajtur kriterëve të paracaktuara në programe dhe udhëzim administrativ, gjë e cila ka mundur të shkaktoj mos përzgjedhjen e fermerëve të kualifikuar. Gjatë vlerësimit të aplikacioneve të fermerëve në disa raste nuk janë marrë parasysh kriteret e parapara, gjithashtu ka mungesë të kontrolleve të vazhdueshme përgjatë fazës së investimeve dhe implementimit të zotimeve në planin e biznesit. Kjo i pamundëson ministrisë të kuptoj nëse mbështetja financiare për fermerë dhe agrobiznese po zhvillohet në mënyrën e duhur dhe nëse po arrihen rezultatet e parapara. Për më tepër as komunat nuk kanë sistem të rregulluar për dhënien e granteve dhe subvencioneve, mungojnë rregulloret dhe strategjitë për sektorin e bujqësisë, paraprakisht nuk bëhet ndonjë analizë për mundësitë e mbështetjes së fermerëve.

Në fund ZKA-ja e ka vlerësuar bashkëpunimin mes ministrisë dhe komunave ku është vërejtur mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit dhe si pasojë ka pasur financime të dyfishta për fermerët.

Përfaqësuesja e ZKA-së gjithashtu thekson, si replikë ndaj deklaratës së ministres, se raporti i performancës, i cili është temë diskutimi, është publikuar me mendimin se janë shteruar dhe diskutuar të gjitha çështjet me Ministrinë e Bujqësisë, mirëpo pas publikimit të raportit Ministria e Bujqësisë ka shprehur pakënaqësitë në formë të shkruar dhe auditori i përgjithshëm i ka dhënë mundësinë që edhe një herë ministria t'i sjellë komentet dëshmuese në mënyrë që të shqyrtohen hollësisht një nga një. Ministria i ka sjellë komentet nga ana e saj dhe ZKA-ja i ka trajtuar komentet dhe çështjet në të cilat palët nuk janë pajtuar, mirëpo qëndrimi i ZKA-së dhe konkluzionet kanë mbetur të pandryshuara.

Përfaqësuesja e ZKA-së e bën të qartë natyrën e raportit, i cili është raport i performancës dhe shkon përtej ligjshmërisë dhe ku vlerësohet efektiviteti dhe rrezikshmëria që mund t'i kanosen sektorit të bujqësisë nëse një praktikë e tillë vazhdon edhe më tej.

Kryetari parashtrroi disa pyetje ku tha se ka të bëjë me programin për zhvillim rural (2014-2020), program mbi të cilin Ministria e Bujqësisë e ka bazuar punën e saj, por i cili nuk është aprovuar sipas proceduarve ligjore, as në Qeveri, e as në Kuvend, pse ka ndodhur një gjë e tillë? Pyetja e dytë, nuk janë vendosur struktura që dalin nga instrumentet për asistencë të para anëtarësimit për zhvillim rural IPARD dhe si pasojë Kosova nuk përfiton nga fondet e BE-së për sektorin e bujqësisë, pse ka ndodhur kjo? Dhe se MBPZHR kishte të bëjë me kompaninë e cila është angazhuar për trajnimin dhe këshillimin e fermerëve. Vetëm për tre vitet e fundit ka marrë një shumë prej 1.3 milion euro, kompania e njëjtë është kontraktuar për tërë Kosovën, më pas e njëjta kompani është kontraktuar përsëri me një shumë prej 249,000 euro për komunat e Leposaviqit, Zubin Potokut, Mitrovicën e Veriut dhe Zveçan. Kërkohet të dihet se kush është kjo kompani, a është e licencuar në Kosovë dhe se a ka kapacitet e duhura për të ofruar trajnime të tilla. Dhe fatkeqësisht nuk ka pasur një monitorim të saktë nga ana e ministrisë rreth efekteve që i ka pasur kjo kompani në trajnime.

Kapllan Halimi për mos aprovimin e programit tha se programi është përgatitur që nga viti 2014 për këtë arsyeje ndoshta do ishte më mirë që të ftohen dy ish-ministrat të cilët kanë shërbyer si udhëheqës politik gjatë kësaj periudhe, pasi që stafi profesional civil ka zbatuar vlerësimet ex-post dhe ex-ante të realizuar edhe nga ekspertët evropian. Përtej kësaj periudhe sekretari shpreh që nuk është pjesë e kompetencave të tij për t'u përgjigjur, se cila ka qenë arsye e mos aprovimit të programit për zhvillim të bujqësisë. Me rekomandimet e ZKA-së ministrja aktuale e ka nxitur procedurën, që programi të aprovohet.

Kryetari – Thekson se komisioni nuk e ka të drejtën për t'i ftuar dy ish-ministrat pasi që mandati i tyre ka përfunduar, por ka të drejtë të kërkojë përgjegjësi nga zyrtarët permanent.

Kapllan Halimi tha se është i gatshëm të ofrojë dokumentacionin e nevojshëm që dëshmon përgatitjen e Programit Zhvillimor. Mirëpo nuk ka përgjigje pse programi nuk është proceduar më tutje për miratim. Përveç programit për bujqësi dhe zhvillim rural 2014-2020 ai tha se ekziston edhe Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, i cili ka një përshkrim të gjerë që i lejon dhe i jep hapësirë ministrisë për zbatimin e programeve. Kjo tha se ka lejuar një lloj harmonizimi strategjik në mes ligjit dhe programit për bujqësi dhe zhvillim rural. Programet hartohet në baza vjetore, mirëpo ministrisë i ka munguar dokumentacioni ombrellë që përcakton vijat themelore të programit. Por duke u bazuar në ligj janë krijuar programet vjetore. Sa i përket pyetjes së dytë sekretari i MBPZHR tha se problemi kryesor qëndron në Ministrinë e Financave, ku duhet të jetë një National Authorization Officer, që i merr mjetet nga Komisioni Evropian, si Ministri e Financave dhe pastaj shpërndahet në institucionet relevante. Kjo nuk është çështje profesionale por është çështje politike. Që nga viti 2014, ministria i ka strukturat e themeluara me pëlqimin e Qeverisë.

Sa i përket trajnimeve për kompanitë, ministria në bashkëpunim me Bankën Botërore bëjnë trajnim dhe edukim për fermerët për arsyeje se niveli i edukimit të fermerëve është i ulët dhe për këtë qëllim ofrohen trajnime për ngritjen e kapaciteteve dhe përgatitjen e dokumentacioneve për aplikim të granteve dhe subvencioneve në baza vjetore.

Përzgjedhja e kompanisë është bazuar në procedurat e prokurimit publik, të gjitha janë publike, madje ka pasur raste të cilat kanë shkuar në Gjykatën e Tenderit dhe për to ka vendosur kjo gjykatë.

Së fundmi ministria ka një analizë nga Organizata Botërore për Ushqim dhe Bujqësi ku vlerësohet niveli i edukimit të fermerëve.

Kryetari pyet se cila është kompania në fjalë?

Kapllan Halimi nuk pranon të përgjigjet publikisht rreth emrit të kompanisë për shkak të ndjeshmërisë së informacionit dhe nuk është i sigurt nëse ligji e lejon një gjë të tillë. Mirëpo nëse pyetja dërgohet me shkrim sekretari është i gatshëm të japë informacionin e kërkuar.

Kryetari, pyet se pse ka ndodhur që komuna veriore të kenë një kontratë të veçantë?

Kapllan Halimi potencon që kjo është një vendim politik, pasi që një pjesë e qytetarëve të Kosovës ka qenë e pa integruar dhe në këtë mënyrë janë hartuar programe të veçanta në mënyrë që të përfitojnë nga skemat financiare që i ka Ministria e Bujqësisë.

Kryetari pyet se cili ministër e ka nënshkruar kontratën për pjesën veriore?

Kapllan Halimi, ish-ministri Rikallo.

Muharem Nitaj, falënderoi përfaqësuesen e ZKA-së për informacionin. Problematika kryesore në vend në raport me Ministrinë e Bujqësisë tha se ka të bëjë me ndarjen e granteve dhe subvencioneve, keq menaxhimin e tyre, vonesat e pajustificuara e çështje të tjera. Dy nga vlerësimet e ZKA-së janë tejet skandaloze. E para shtoi se është mosarritja e objektivave gjatë viteve 2016-2017 -2018 dhe që investimet në sektorin e bujqësisë nuk kanë treguar rezultat. Ndërkohë në anën tjetër sekretari i MBPZHR shprehu që nuk janë pajtuar me të gjeturat e auditorit, edhe kjo çështje duhet të trajtohet.

Kapllan Halimi tha se ministrja e përmendi më herët që është bërë një vlerësim afatmesëm i programit që është në kundërshtim me të gjeturat e auditorit. Ky vlerësim është bërë nga ekspertët e Komisionit Evropian për të parë se sa po arrihen objektivat e programit dhe se a ka nevojë për ndonjë ndryshim. Ka të gjetura që theksojnë faktin se duhet të ketë thjeshtësim të procedurave dhe për një qasje më ndryshe ndaj fermerëve të vegjël dhe ministria këto të gjetura është duke i adresuar. Vitin e kaluar ka pasur dy pilotë masa të veçanta për t'i adresuar këto çështje, pra është bërë një vlerësim profesional mbi efektivitetin e programit i zhvilluar nga ekspertët e Komisionit Evropian. Kjo çështje

është diskutuar me ZKA-në pasi që raportet kanë shumë kundërthënie në mes tyre. Nëse i shohim konstatimet e auditorit mbi bazën e cilës analizë nuk janë implementuar objektivat lë vend për të dyshuar, ministria dyshon në përzgjedhjen e metodologjisë nga ZKA-ja e cila është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të auditimit që përdoren nga Komisioni Evropian, për këtë arsye ka mospërputhje të mëdha. Të gjeturat e ZKA-së janë apeluar zyrtarisht duke ofruar evidencë dhe fakte.

Avdullah Hoti tha se raporti tregon se për tre vitet e fundit janë shpenzuar mbi 140 milionë euro në subvencione të bujqësisë nga niveli qendror dhe ai lokal. Të dhëna që nuk janë në raportin e ZKA-së tregojnë se importi i prodhimeve bujqësore gjatë këtyre tre viteve ka mbetur pothuajse i njëjtë ose në rritje. Kjo tha ai se nënkupton që të gjitha subvencionet që jepen për zhvillimin e bujqësisë nuk po ndikojnë në rritjen e prodhimit vendor që fillimisht ta zëvendësojë importin dhe më pas të rritet eksporti. Shembull konkret tha z. Hoti se është rasti me grurë, sipërfaqet e grurit kanë rënë me 20% këto tre vite ndërsa rendimenti ka mbetur i njëjtë. Pyetja kryesore sipas tij është se ku po shkojnë këto subvencione? Ai shtoi se e gjithë kjo ndodh për faktin se nuk ka asnjë analizë adekuate ex-post, për këtë arsyeje subvencionet nuk kanë asnjë efekt. Një çështje tjetër që është ngritur në një rën prej seancave është udhëzimi administrativ diskriminues, i cili për katër komunat në veri mbulon 80% të investimeve përmes granteve, ndërsa bujqve në komunat tjera u mbulon vetëm 50%, nuk ka asnjë dokumentacion që e arsyeton këtë diskriminim. Çështje tjetër që z. Hoti ngriti është mosharmonizimi i udhëzimit administrativ me programin vjetor që hartohet nga ana e sekretarit. Një problem në dukje teknik por substancial është qasja e dy personave në sistemin e IT-së, drejtorit të IT-së dhe kryeshefit të AZhB, që kanë qasje si kryeadministratorë të sistemit dhe nuk ekziston asnjë monitorim në rast ndërhyrje.

Ministrja e Bujqësisë theksoi se sa i përket monitorimit, për grandet dhe subvencionet e ndara, ju informoj se ne kemi angazhuar organizatën BIRN, po ashtu në mbështetje kemi edhe shume ambasada këtu, po ashtu unë ju kisha lutur edhe juve të nderuar deputetë që bashkë të jemi sa me transparent në procesin e mbikëqyrjes së përfituesve, çdo parregullsi që mund të na ofroni ju ne mund ta analizojmë dhe t'i rregullojmë shkeljet aty ku mund të ketë.

Ekrem Gjokaj (kryeshef i AZHB-së), theksoi se nëse analizohet importi i produkteve bujqësore duhet të analizohet edhe pjesa e eksportit, pasi që eksporti i prodhimeve bujqësore në vitin paraprak është rritur për 35.5%. Synimi i AZHB-së sipas tij është zvogëlimi i plantacioneve të grurit, për faktin se nuk është e arsyeshme të ketë sipërfaqe të mëdha me rendiment 3.5 tonë hektarë, përderisa prodhuesit në Serbi marrin 15 tonë. Ideja është këto sipërfaqe të zvogëlohen dhe të rriten sipërfaqet me pemishte pasi aty qëndron edhe përparësia krahasuar me vendet tjera. Kjo tregon se nuk duhet të shihen vetëm trendet negative por duhet të promovohen edhe aspektet pozitive. Çështja e dytë, shtoi se 80% e Udhëzimit Administrativ që është në fuqi është bërë për një masë të veçantë në pjesën veriore, ka qenë një vendim politik i bazuar në analizë. Analizat janë bërë prej projektit DANIDA. Asnjë projekt nuk realizohet pa e pasur garancionin bankar gjë që theksohet edhe në udhëzimin administrativ. Ekziston ex-posti i 2016 dhe tash po realizohet edhe për vitin 2017 mirëpo auditori mund t'i ketë ikur ky informacion. Kryetari i Agjencisë kërkon mbështete në aspektin e stafit. Z. Gjokaj tha se Principi i vlerësimit mbi katër sy sipas IPARD-it nuk lë hapësirë që kryeshefi ose drejtori të manipulojnë me rezultatet në sistemin e IT-së, mirëpo kushdo që ka dyshime mund ta auditojë sistemin.

Avdullah Hoti kërkoi përgjigje konkrete për rastet kur mjetet merren nga ana e përfituesve të granteve dhe subvencioneve dhe nuk përdoren fare, cilat janë masat që merren kundër këtyre rasteve?

Ekem Gjokaj tha se hapi i parë që ndërmerret është kthimi i mjeteve, ku në gjykatë ekzistojnë mbi 360 lëndë për kthimin e mjeteve si raste gjyqësore. Sa i përket sistemit të IT-së janë pranuar rreth

1775 aplikacione brenda vitit 2018 dhe me qëllimin e vetëm që të monitorohet procesi pa pasur mundësi në ndërhyrje është lejuar qasja e kryeshefit të AZHB-së.

Besa Gaxherri sugjeron që urgjentisht ministrja të merret me çështjet e ngritura nga raporti i ZKA-së, pasi askush nuk mund t'i ikë përgjegjësisë. Vetë mos miratimi i programit për zhvillim rural 2014-2020 përbën shkelje dhe duhet të merret parasysh se për tre vite janë ndarë 130 milionë buxhet nga qeveria dhe kjo përbën shqetësim të madh duke parë se nuk ka produkt të këtij investimi. Tejkalmi i buxhetit për grande ka ndodhur për shkak të dy programeve, por nuk është e qartë se çka janë këto programe. Për procesin e aplikimit për grande dhe subvencione znj. Gaxherri tha se janë katër aplikacione elektronike, mirëpo mungon përshkrimi i roleve dhe udhëzimeve për përdorimin e tyre e as janë të përshkruara kufizimet në ndërhyrje të sistemit për dy super administratorët gjë që përbën rrezik. AZHB-ja tha se duhet të ketë analizë për secilin investim dhe kulturë bujqësore.

Salih Zyba tha se dalja nga mbledhja e sekretarit të përhershëm tregon se mendojë se janë edhe të paprekshëm nga llogaridhënia dhe assesi nuk duhet të arsyetohet mungesa e tij. Kontestimi i kredibilitetit të raportit të ZKA-së nga ana e ministres është shumë e pavend, për arsye se as ky debat s'do kishte kuptim. Gjithashtu ministrja ka mungesë të bashkëpunimit dhe komunikimit me Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor.

Muharrem Nitaj drejtoi dy pyetje te përfaqësuesit e Auditorit të Përgjithshëm, e para se a janë pajtuar që raporti i auditimit të jashtëm ka të gjetura të bazuara dhe e dyta që raport i auditimit të jashtëm është kontestuar edhe nga ekspertet e jashtëm për sa i përket metodologjisë dhe fushëveprimit të auditimit?

Besa Gaxherri kërkoi të ndërpritet takimi, pasi që sipas saj nuk janë në gjendje të japin përgjigje pyetjeve të parashtruara nga komisioni.

Muharrem Nitaj tha se autoriteti më i lartë i ministrisë është prezent dhe se për deri sa është kështu takimi nuk mund të ndërpritet.

Salih Salihu tha se shqetësues është që plani kombëtar 2014-2020 nuk ka ardhur as në Qeveri as në Kuvend, mungon një strategji afatgjate për bujqësi ku rezultatet nuk mund të shihen në fund pasi që vendoset për një plan vjetor që i përshtatet votave dhe elektoratit. Si pikë e dytë z. Salihu tha se 1.1 miliard ka konsum ku 800 milionë importohen, kurse të tjerat prodhohen brenda vendit dhe se ndahen vetëm 48 milionë euro për bujqësi. Theksoi se një sektor kaq i rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë së vendit neglizhohet dhe ndaj në pak buxhet. Salihu shtoi se është e rëndësishme të rriten fondet për grurë por sipas tij do të duhej të ketë 100 mijë hektarë grurë dhe të ketë rritje të rendimentit. Mungon koordinimi mes institucioneve, pasi që sipas tij kemi CEFTA-n e cila është vetëvrasje për bujqësinë e Kosovës dhe se nuk ka as një mbrojtje sezonale të produkteve bujqësore.

Ali Lajçi tha se Ministria e Bujqësisë punon në mënyre arbitrare, pa programe të aprovueshme dhe këto programe nuk janë në këtë mandat. Këto programe që implementohen, zbatohen dhe janë programe të grupeve, të cilat bëhen për t'i kënaqur ato sepse nuk e kemi programin e aprovuar. Prandaj ai tha se është nevoja që të shtohet auditimi i performancës. Auditimi i performancës ka rëndësi më të madhe për shkak një pasqyrim më të sakët të arritjes së objektivave.

Emilia Rexhepi theksoi se po pajtohem me koleget e mi për parregullsitë që po ndodhin në këtë ministri, dhe po shpresojë shumë që ju si udhëheqëse e re të punoni për ndryshime pozitive edhe pse jam shumë skeptike duke pasur parasysh çka ndodh në këtë ministri, sepse kam qenë në mandatin e kaluar anëtare e komisionit për bujqësi dhe në vazhdimësi kemi pasur skandale dhe askush asnjëherë s'ka bartur përgjegjësi për këto veprime, dikush u arsyetua që nuk është përgjegjësi e jona po e agjencisë për zhvillim të bujqësisë e dikush është përgjegjës në komuna, por askush nuk ka marrë përgjegjësi. Unë kam kohë që e përcjell punën e kësaj ministrie dhe e di që shifra të mëdha parash për subvencione dhe grandeve shkojnë te njerëzit jo adekuat, prandaj e vlerësoj se ekonomia e një vendi

nuk mund të zhvillohet nëse nuk ka një zhvillim të duhur të bujqësisë. Prandaj e vlerësoj që duhet të bëhet një kontroll më e mirë sa i përket ndarjes së granteve dhe subvencioneve dhe jo që këto të fokusohen kryesisht te individ të cilët as nuk i njohin institucionet e këtij vendi dhe as nuk janë persona adekuat me të cilët do të duhej të përfitojnë, sepse kemi komuna të varfra të cilët me një ndihmesë të vogël mund të prodhojnë shumë dhe të zhvillohen! Pra, ne i përcjellim krejt se kush dhe si përfitohet. Prandaj shpresoj që ti, si ministre e re, do t'i rishikosh këto kritere, jo të mira sa i përket përfitimit edhe të minoriteteve të tjera jo serbe, sepse ministria nuk është as e jona as e juaja, por është e të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe ju jeni personi përgjegjës në këto momenti që t'i rregulloni këto çështje.

Hetem Arifi, komentoj deklaraten e z. Petroviq duke thënë se ka pasur ndërhyrje të politikës së Gjuriqit, Lista Serbe dhe disa nga shefat tanë për të investuar diku më shumë e diku fare. Arifi tha se është shumë e vërtetë që politika ka ndërhyrë dhe se pa dashur të del në mbrojtje të askujt; ka pasur keqpërdorime të granteve e subvencioneve dhe gjithashtu komuniteti rom nuk ka pasur qasje në këtë organ dhe subvencione për shkak të kritereve që i ka ministria. Komunitetet janë shumë të interesuara që të punojnë në këtë fushë dhe të zhvillojnë sektorin dhe tha se pret që do të ketë ndryshim të kritereve që e mundësojnë këtë.

Albert Kinolli theksoi se nga fondet e ndara nga ministria, komuniteti serb është favorizuar dhe janë favorizuar komunitetet që votojnë në pjesën veriore të cilat nuk e pranojnë realitetin e Kosovës. Ai pyeti nëse në politikën zhvillimore të Ministrisë së Bujqësisë a është paraparë që për komunitetet pakicë të ketë kritere vlerësuese që edhe këto komunitete të jenë përfituese të këtyre granteve, duke ditur që asnjëri prej komuniteteve nuk arrijnë që t'i plotësojnë as për së afërmi kriteret e vendosura nga ministria. Duke marrë parasysh diskriminimin pozitiv për komunitetin serb në pjesën veriore, z. Kinolli kërkoi nga ministria dhe nga sekretari i Ministrisë së Bujqësisë që të parashohin kritere lehtësuese për komunitetet tjera të cilat kanë kontribuar dhe kontribuojnë në shoqërinë kosovare.

Vlora Spanca iu përgjigj pyetjes së z. Nitaj ku tha se ZKA ka pasur takime të shumta me ministrin, auditorin dhe zëvendës auditorin dhe se është e përcaktuar me standard që ZKA nuk mund të dakordohet për të ndryshuar raportin. Ajo the se raporti mund të ndryshohet vetëm në bazë të fakteve, dëshmi dhe se ZKA i ka ofruar rastin për t' i sjellë dëshmitë të cilat i kanë shqyrtuar. Gjithashtu ajo shtoi se raporti i vlerësimit afat-mesëm e ka një mendim krejt ndryshe prej asaj që ZKA ka paraqitur në raport. Raportin e vlerësimit, sekretari i Ministrisë së Bujqësisë asnjëherë nuk e ka sjellë për të dëshmuar të kundërtën. ZKA nuk e ka raportin i cili është publikuar në prill 2018. Zonja Spanca potencoi edhe çështjen e programit të veçantë për banim. Ajo tha se program i rregullt vjetor kur është hartuar ka qenë të formuara grupet punues gjithëpërfshirëse dhe ne nuk kemi vërejtje. Te programi i veçantë, kryesuese e komisionit ka qenë vetëm këshilltarja e ministrit, dhe fokusi ka qenë vetëm te ministrja e bujqësisë. Ky ka qenë shqetësimi ynë. Ligji i Ministrisë së Bujqësisë thotë se programet duhen të jen gjithëpërfshirëse, këtë program të veçantë për zonat përkatëse kanë mundur që ta akomodojnë shumë lehtë përmes programit të rregullt vjetor. Ne kemi kërkuar analiza, por me analiza dalin informacione pse është bërë ky, a ka të dokumentuar, ne jemi auditor dhe neve na duhet dokumenti dhe jo fjalë çka i marrim ne takime. Pa dëshmi nuk mund të behën ndryshimet.

Çështja e tejklimit të buxhetit: Ju e keni ligjin e buxhetit, shumen për grante sa e keni aprovuar. 21 milionë janë aprovuar për grante ndërkaq 27 milionë është programi vjetor. Do të thotë së bashku me programin e veçantë e ka tejkalar për 5 milionë. Zotëri Kapllani ka thënë se e kam edhe buxhetin e subvencioneve që mund ta përdori për grante. Mirë e përdorë edhe atë, por prapë e keni tejkalimin dhe konkluzioni i përgjithshëm mua nuk më ndryshon, sepse keni bërë program vjetor, do të thotë dy programe ke përgatitur ku 27 milionë ka qenë, plus nëse ia shtojmë edhe subvencionet 25 atëherë kemi 52 milionë. Ndërkaq buxhetin total e ka 47 milionë. Prandaj unë nuk mund të iku nga faktet. Tjera, 90 milionë janë obligime, për çka po i vijnë 90 milionë obligime, ku duke marrë parasysh se nga buxhetin i vitit 2018 janë paguar obligimet e mbetura të vitit 2017. Te çështja e paradhënies kanë ngritur

dyshime. Në ligj të buxhetit është e përcaktuar veç për investime kapitale, për mallra dhe shërbime, nuk është për subvencione, ne kemi biseduar edhe me thesarin. Nuk ka kod ekonomik për subvencione, prandaj ne kemi thënë që të bisedohet me ministrin e Financave rreth udhëzimit administrativ, që të sigurohemi se është në përputhje me rregullat e financave sepse vlerat janë të mëdha. 50 % - gjysmë milion euro deri sa edhe ligji i buxhetit e ka përcaktuar për investime kapitale për x%, ku 30% merret me aprovim të Ministrisë së Financave. Te çështja e përfituesit: ku kemi thënë se nuk ka përvojë në agrobiznes primar dhe sekondar, përfituesi i ka 57% të aksioneve në atë konzercium përderisa është përfituesi kryesorë të avancimit prej gjysmë milion euro.

Përfundimi

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike vendosi që raporti i auditimit “Procesi i menaxhimit të granteve dhe subvencioneve për sektorin e bujqësisë” të adresohet në seancë plenare së bashku me rekomandimet e komisioni të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

4. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018

Kryetari: Theksoi se për shkak të zgjatjes së minutave të diskutimeve për raportin e bujqësisë, raportit të Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, do të diskutohet në mbledhjen e radhës së komisionit. Me këtë kërkon nga administrata e komisionit që në mbledhjen e radhës të ftojë ministrin e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

5. Të ndryshme

Meqenëse nuk ka pasur diskutim për këtë pikë të rendit të ditës kryetari mbylli takimin.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj